



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS / TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/
KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

BULETINI MUJOR

Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Maj 2018

Krerët e sistemit prokurorial dhe gjyqësor kanë pritur në takim një delegacion të BE-së për liberalizim të vizave

Krerët e sistemit prokurorial dhe gjyqësor të Kosovës, kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, kryeprokurorë dhe kryetarë të prokurorive dhe të gjykatave, janë takuar me delegacionin e Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave të kryesuar nga zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për Migrim dhe Azil i Komisionit Evropian, Simon Mordue.

Krerët e sistemit prokurorial dhe gjyqësor gjatë takimit me delegacionin e BE-së kanë paraqitur aktivitetet dhe punët e realizuara të cilat janë të lidhur me kriteret për liberalizimin e vizave.

Delegacioni i BE-së pasi kanë vlerësuar përkushtimin e sistemit prokurorial dhe gjyqësor, kanë parashtruar pyetje në fushën e interesit të misionit të tyre.



Diskutohet drafti i marrëveshjes së bashkëpunimit KPK-UP



Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka trajtuar draft-Marrëveshjen e Bashkëpunimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Universitetit të Prishtinës (UP).

Komisioni pasi ka analizuar draftin e marrëveshjes, i ka propozuar kryesuesit të KPK-së, Blerim Isufaj nënshkrimin e kësaj marrëveshje.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është vendosja e bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Universitetit të Prishtinës (UP), për kryerjen e ekspertizave dhe super ekspertizave nga ana e ekspertëve të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, me qëllim të përkrahjes së proceseve për avancimin e sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

Diskutohet kërkesa e parë buxhetore për vitin 2019

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), ka diskutua kërken e parë buxhetore për vitin 2019, si dhe vlerësimet e hershme për vitet 2020-2021.

Kërkesa buxhetore për rritje të numrit të punëtorëve dhe për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte temë tjetër e këtij takimi. Po ashtu u bisedua për kërkesat buxhetore të kategorive mallra e shërbime dhe investime kapitale.



Takimi i Bordit të Përbashkët Koordinues për Sundimin e Ligjit



Shefja e Zyrës së BE/Përfaqësuesja e Posaçme e BE-së, Natalija Apostolova, Shefja e Misionit të EULEX-it në Kosovë, Aleksandra Papadopoulou, Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, së bashku me Kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi dhe Kryetarin i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj, mbajtën takimin e Bordit të Përbashkët Koordinues për Sundimin e Ligjit (BPKSL).

Gjatë këtij takimi, kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj, i informoi anëtarët e BPKSL për progresin e arritur kohët e fundit nga sistemi prokurorial në Kosovë, me theks të veçantë në aktivitetet e planifikuara për përmirësimin e mëtejshëm të administratës nëpërmjet legjislacionit sekondar, projekt-strategjive dhe politikave përkatëse.

Mbahet takimi i radhës i Këshillit Prokurorial të Kosovës



Në takimin e njëqindpesëdhjetedy të Këshillit Prokurorial të Kosovës, lidhur me aktivitetet e zhvilluara për periudhën janar–mars 2018, kanë raportuar Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, komisioni për mbikëqyrjen e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, si dhe anëtarë të Këshillit Prokurorial, për Raportin e Mekanizmit përcjellës ndër-institucional për Harmonizimin e statistikave për veprat penale karakteristike, raporte të cilat edhe u miratuan nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi ka njoftuar Këshillin me raportin e Prokurorit të Shtetit për vitin 2017, ndërsa kryesuesi i Këshillit, Blerim Isufaj ka njoftuar Këshillin lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar në mes të Këshillit Prokurorial dhe Universitetit të Prishtinës.

Drejtori i Sekretariatit, Lavdim Krasniqi ka njoftuar Këshillin për vendosjen në funksion të databazës për të dhëna sipas udhëzimit për normë, ndërsa është marrë vendim për shpalljen për avancim për prokurorë për 5 pozita në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

SEKRETARIATI I KPK-SË

Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi me udhëheqësit e njësive të Sekretariatit përmes video konferencës kanë mbajtur takim me administratorët e prokurorive të Republikës së Kosovës.

Në këtë takim është diskutuar për planifikimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2019-2021.

Ndërsa, administratorët kanë prezantuar planifikimet buxhetore të kornizës së lartcekur të prokurorive të tyre.


Sekretariati gjatë këtij muaji ka mbajtur një punëtori ku ka punuar në përgatitjen e komenteve për hartimin e një Projekt-Ligji dhe kanë diskutuar për hartimin e disa udhëzimeve administrative.

Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të BE-së "Fuqizimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë" një grup i punëtorëve të administratës së sistemit prokurorial të Kosovës në pjesën e dytë të majit kanë realizuar vizitë studimore në France në Këshillin e Lartë të Drejtësisë Franceze.

Qëllimi i kësaj vizite ishte fitimi i përvojave dhe njohurive në organizimin e punëve në sistemin prokurorial të Kosovës, gjithnjë duke u bazuar në këndin krahasimorë të sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe Francës.



NJËSITIT I KPK-SË



Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive (Njësiti) ka përgatitur statistika dhe raporte të cilat do t'i shërbejnë prokurorëve dhe sistemit prokurorial në përgjithësi për punët në vazhdim. Po ashtu, ka përgatitur statistika për nevojat e palëve (gazetar, student etj.) të jashtme.

Njësiti ka bërë identifikimin e të gjeturave të Raportit të Komisionit Evropian për Vendin dhe ka përgatitur komente e të gjeturave të raportit të cekur, që lidhen me fushë-veprimtarinë e sistemit prokurorial të Kosovës.